



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1574 prot

Himarë më 30.03 2022

VENDIM

Nr. 16 datë, 30.03 .2022

PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË
PËRKOZHME, PËR VITIN 2022

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, vendimit nr. 62, datë 23.12.2021 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Himarë për vitin 2022” të Këshillit Bashkiak Himarë,

Këshilli Bashkiak Himarë në mbledhjen e tij të datës 30 .03.2022 pasi mori në shqyrtim materialin e përgatitur nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse mbi përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2022 miratoi me 12 vota pro, 0 kundra , 0 abstenim dhe ...

VENDOSI:

1. Përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2022, për Bashkinë Himarë, i cili do të jetë 15 punonjës, 13 punonjës sezonal mirëmbajtje dhe 2 edukatore kopshti-çerdhe.
2. Pagesa do të bëhet në mbështetje të vendimi nr. 55, datë 25.11.2021 të Këshillit **Bashkiak** “Për miratimin e numrit të përgjithshëm dhe nivelin e pagave të punonjësve të Bashkisë Himarë për vitin 2022”.
3. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi do të përballohen nga buxheti i Bashkisë Himarë për vitin 2022.
4. Ngarkohet drejtoria e burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

KRYETARI

Dhimitër Kapaj

